



Nr.Prot. 27/24



RESPUBLICA

KËRKESË

KËRKUES:

Qendra "Res Publica",
person juridik i regjistruar në gjykatë
me Vendimin nr. 604 dt. 13.04.2010,
përfaqësuar nga Z. D M

Adresa: Blv "Gjergj Fishta", Nd.24, H.3, Ap.7, Tiranë
Email: qendra.respublica@gmail.com

DREJTUAR:

Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Adresa: Rruga e Kavajës, Tiranë

Për dëjten:

Koordinatorës për të drejtën e informimit Znj. Joniada Koçi

OBJEKTI:

Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion e dokumentacionit

BAZA LIGJORE:

Ligji nr.119 dt. 18.09.2014 "Për të Drejtën e Informimit", i ndryshuar
Neni 23 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë
Neni 10 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut
Neni 19 i Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike,

E nderuar Znj. Koordinatorës,

Qendra Res Publica është e angazhuar ti shërbejë publikut për të bërë transparencën e institucioneve e cila ndikon drejtëpërsëdrejti në mirëqeverisjen e vendit. Në shërbimin online www.publeaks.al ka mbërritur kërkesa e një qytetari për tu informuar në lidhje me:

- Kopje të shkresës së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me Nr. 4800 Prot, datë 20.12.2023 drejtuar Kuvendit të Shqipërisë, me objekt "Kërkesë për mbështetje të iniciativës ligjvënëse".

Kjo kërkesë bazohet në nenin 3 të ligjit të sipërpërmendur, i cili shprehet:

"Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit."

Kopje e dokumenteve të sipërpërmendura mund të na i dërgoni në adresën e emailit ose në adresën postare:

Adresa: Blv "Gjergj Fishta", Nd.24, H.3, Ap.7, Tiranë

Për çdo komunikim tjetër me qëllim orientimin dhe sqarimin e paqartësive, mund të më kontaktoni edhe në:

email: qendra.respublica@gmail.com

Duke mbetur në pritje të një përgjigjeje të shpejtë dhe pozitive nga ana Juaj, Ju falenderoj për mirëkuptimin.

Me respekt,
Av. D M
Drejtor Ekzekutiv
Qendra "Res Publica"

Datë më 27.02.2024